



Pranimi / Dorezuar Prilpjenar/Prilidato Received/Delivety	30	11	2021	1	viti god year
Organ /Kjesta Organ /Jedinstva Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypje Printed Appendix	Sasia Policina Quantity		
SKOPJESHK	5792	2021	4/5		



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.895/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj dhe Arben Mehmeti-anëtar dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas aktgjykimit A.nr.103/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ka shqyrtuar ankesën me numër, A.nr.632/2019 të datës 17.10.2019 të parashtruar nga ankuesja me adrese banimi Rr."Zenel Hajdini", Komuna e Klinës, në çështje juridike "Kontestim Konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.632/2019 e datës 17.10.2019 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 02.10.2019 lidhur me rezultatin përfundimtar të procedurës së rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Tatim në Pronë" i Sektorit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës.

A r s y e t i m

Ankuesja, _____ kandidatë për praninë në Shërbimin Civil, me datë 17.10.2019 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 4890/2019 të regjistruar me numër A.nr.632/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës

aplikimit të kandidatës së bashku me dëshmitë e përvojës së punës dhe përgatitjen profesionale: Formularin e aplikimit të kandidatit së bashku me dëshmitë e përvojës së punës dhe përgatitjen profesionale: Formularin e aplikimit të kandidatës së bashku me dëshmitë e përvojës së punës dhe përgatitjen profesionale: Formularin e aplikimit të kandidatit së bashku me dëshmitë e përvojës së punës dhe përgatitjen profesionale: Formularin e aplikimit të kandidatës së bashku me dëshmitë e përvojës së punës dhe përgatitjen profesionale: Raportin e datës 25.09.2019 nga testi me shkrim dhe datën e mbajtjes së intervistës me gojë: Raportin final të datës 01.10.2019 nga testimi me shkrim dhe intervistës me gojë: Form.MAP-SHCK-10 Renditjen përfundimtare të kandidatëve: Form.MAP-SHCK-09 Përmbledhjen e vlerësimeve individuale: Testin me shkrim të datës 20.09.2019 për kandidatet e përzgjedhur në listën e ngushtë nga Komisioni për plotësimin e vendit të lira të punës Zyrtar Tatimore në Pronë: Flete dërgesë e datës 14.10.2019: Njoftimin e datës 10.10.2019: Ankesën e datës 10.10.2019 me numër 02-112-42566/2019 të parashtruar nga ankuesja në Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave: Emalin e datës 09.10.2019; Njoftimin e datës 05.11.2019; Kërkesën e datës 16.12.2019; Emalin e datës 11.02.2021: Emalin e datës 10.11.2021; Përgjigjen e datës 11.11.2021 me numër të protokollit 5397/2021; Ndryshimin dhe plotësimin e Aktit të Emërimit të datës 01.10.2013; Aktin e Emërimit të datës 29.09.2018; Aktin e Emërimit të datës 21.10.2021; Aktin e Emërimit të datës 26.11.2019; Aktin e Emërimit të datës 01.08.2011;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses: është e **pabazuar**, *sepse:*

Bazuar në shkresat e administruara të lëndës është konstatuar se Komuna e Klinës në bazë të autorizimit të Departamentit të Administrimit të Shërbimit të Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 23.08.2019, me datë 26.08.2019 ka shpallur konkursin për pozitën "Zyrtar për Tatim në Pronë". Në këtë konkurs ka aplikuar edhe kandidatja dhe e njëjta është ftuar të marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit (testin me shkrim dhe me gojë). Komuna e Klinës pas përfundimit të procedurave të rekrutimit, më datë 02.10.2019 ka publikuar rezultatet përfundimtar të procedurës së rekrutimit, në bazë të të cilit ankuesja nuk është rekomanduar për emërim në pozitë.

E pa kënaqur me Njoftimin e datës 02.10.2019 lidhur me kandidatin e suksesshëm, me datë 10.10.2019 ankuesja i është drejtuar me ankesë Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Komunës së Klinës. Zyra e Personelit në Komunën e Klinës ka njoftuar të njëjtën se palët e pakënaqura mund të ushtrojnë mjete juridike drejtpërdrejtë në KPMSHCK, tridhjetë (30) dite nga data e publikimit të rezultateve.

Ankuesja, më datë 17.10.2019 ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se: Kandidati i përzgjedhur nuk është pranuar pse është kandidati me i suksesshëm po se është aktivist i partisë e cila është në pushtet; Kandidati i përzgjedhur sa i përket përgatitjes profesionale ka vetëm nivelin bachelor ndërsa ankuesja ka edhe nivelin master; Testi me shkrim është manipuluar në favor të kandidatit të përzgjedhur; Është zbatuar në mënyrë të gabuar Ligji për Shërbimin Civil sepse i njëjti është



shfuqizuar me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili në nenin 83 paragrafi 9 ka përcaktuar mënyrë e përfundimit të konkursit të shpallur; si dhe pretendimin ankimor se Zyra e personelit në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi që rregullojnë procedurat e rekrutimit pa kurrfarë paralajmërimi ka zëvendësuar anëtarin e Komisionit Përzgjedhës

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ka shqyrtuar kriteret e konkursit të përcaktuara në konkursin e datës 26.08.2021, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se për pozitën e punës "Zyrtar për Tatim në Pronë" në kuadër të Drejtorisë për Financa Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Klinës, kriteret e konkursit kanë qenë: *"Diplomë universitare, fakulteti Ekonomik ose Biznes pa përvojë pune ose shkollë e lartë me 2 vite përvojë pune"*. Në bazë të shkresave të lëndës gjegjësisht Diplomën me Nr.1611 të datës 29.12.2016 të lëshuar nga Universiteti "Haxhi Zeka" Pejë, konstatohet se kandidati i rekomanduar për këtë pozitë Zef Nrecaj me datë 16.10.2014 ka përfunduar studimet themelore në Administrim Biznesi, dhe rrjedhimisht ka plotësuar kriterin e konkursit lidhur me kualifikimin, kështu që pretendimi ankimor i ankueses në këtë kuptim është i pabazuar. Kolegji po ashtu duke iu referuar Renditjes Përfundimtare të Kandidatëve, ka gjetur se kandidati i përzgjedhur pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë është vlerësuar me 78.4 pikë ndërsa ankuesja është renditur e dyta me 76.5 pikë, andaj në shërbimin civil emërohen kandidatët që kanë numërim më të madh të pikëve siç parashihej me nenin 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *"Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë"*, andaj pretendimet ankimore të ankueses janë të pa bazuara.

Kolegji, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur së anëtarja e Komisionit Përzgjedhës është zëvendësuar me _____ pas kërkesës me shkrim që e kishte parashtruar e njëjta, për shkaqe familjare. Mirëpo siç shihet nga shkresat e lëndës, ankuesja pas këtij zëvendësimi nuk ka parashtruar ndonjë kërkesë për tërheqje të ndonjë anëtari siç përcaktohet me nenin 30 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor për zbatim të gabuar të Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil dhe Rregullores Nr.02/2010 për procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ka analizuar dispozitat e këtij ligji dhe Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se organi i punësimit ka zbatuar drejtë ligjin material, sepse konkursi për pozitën e punës "Zyrtar për Tatim në Pronë" është shpallur me datë 26.08.2019 në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, andaj edhe zhvillimi dhe përfundimi i procedurës është bërë sipas dispozitave të këtij ligji, gjegjësisht Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.895/2021;

Ilire Mehmeti Shaqiri


Procesmbajtëse


Jeton KOCA
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Klinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së